



Datë: 02.02.2026
Numër Protokolli: 664/2026

A.nr.2085/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtar, më Sabile Avdyli, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.2085/2025, të datës 29.12.2025, të parashtruar nga ankuesja, S.G-S, kundër organit të punësimit: Shërbimi Sprovues i Kosovës, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.02.2026, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet në tërësi si e bazuar** ankesa me numër A.nr.2085/2025, e datës 29.12.2025, e parashtruar nga ankuesja, S.G-S.
- II. Anulohet** Njoftimi i datës 26.12.2025, i Divizionit për Burime Njerëzore të Shërbimit Sprovues të Kosovës, lidhur më shpalljen e rezultateve përfundimtare në procedurën e pranimit më numër Reference: RN00018927, pozita Zyrtar Sprovues si dhe të gjitha veprimet administrative të ndërmarra në fazën e verifikimit paraprak dhe fazën e vlerësimit profesional, ndërsa, çështja kthehet në rishqyrtim të aplikacioneve të kandidatëve aplikues në këtë procedurë.
- III. Obligohet** Njësia e Burimeve Njerëzore e institucionit gjegjes që në fat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmerr të gjitha veprimet për zbatimin e vendimit sikurse përcaktohet në pikën II të dispozitivit si dhe të bëjë rishqyrtimin e aplikacioneve të kandidatëve në pajtim më pikëpamjet juridike si në arsyetimin këtij vendimi. Ndërsa, Drejtori Ekzekutiv i Shërbimit Sprovues të Kosovës pas fazës së verifikimit paraprak të themelojë Komisionin e ri të pranimit në pajtim më kërkesat sipas nenit 40 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 29.12.2025, përmes postës elektronike ankesa.kpmshck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00018972, për Grupin e shkencave shoqërore, respektivisht për pozitën e punës Zyrtar Sprovues, i shpallur nga Shërbimi Sprovues i Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 08.01.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Shërbimin Sprovues të Kosovës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 13.01.2026, ka përcjellë përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 8117/2025, të datës 29.12.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; ; Formularin për parashtrimin e ankesës të datës 29.12.2025; Konkursin me numër reference RN00018927, të datës 27.10.2025; Vendim i datës 10.12.2025; Kopjen e letërnjoftimit të ankuses; Lista e aplikantëve (të aprovuar dhe refuzuar); Lista me kandidatët të cilët e kanë kaluar fazën e verifikimit paraprak, të datës 10.12.2025; Vendim për themelimin e komisionit të pranimit me numër protokolli Nr.104, i datës 17.12.2025; Akt emërimi me numër Nr.12/2025, i datës 27.06.2025; Akt emërimi me numër Nr.11/2025, i datës 27.06.2025; Akt emërimi me numër Nr.09/2024, i datës 01.09.2024; Akt emërimi me numër Nr.19/2025, i datës 22.08.2025; Akt emërimi me numër Nr.05/2025, i datës 02.06.2025; Formulari i planit individual të personelit; Kërkesë për fillimin e rekrutimit; Testi individual i datës 19.12.2025; Formularët e vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë, të datës 26.12.2025; Njoftimi datës 26.12.2025; Vendim i datës 10.12.2025; Aplikacioni me datë aplikimi 16.09.2025, i ankuses S.G-S me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Aplikacioni me datë aplikimi 25.11.2025, i kandidates A.M, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e bazuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Shërbimi Sprovues i Kosovës, më datë 27.10.2025, ka shpallë konkursin me numër reference RN00018927, për Grupin e shkencave shoqërore, gjegjësisht për pozitën e punës Zyrtar Sprovues, me klasë të pozitës Profesional 2, dy (2) vend pune, i hapur për aplikim nga data 28.10.2025 deri më datë 26.11.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë 127 kandidatë, ku prej tyre 69 kandidatë janë përfshirë në listën e ngushtë, si kandidatë që kanë plotësuar kriteret për pozitën e shpallur, ndërsa sipas Njoftimit të datës 19.12.2024 rezulton se ankuses i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se nuk ka bashkangjitur dëshmi të mjaftueshme të punësimit.

Tutje, Divizioni i Burimeve Njerëzore në Shërbimin Sprovues të Kosovës, më datë 26.12.2025, ka publikuar Njoftimin nga i cili rezulton se kandidatja A.M, me gjithsejtë 81.2 pikë të arritura është shpallur kandidatë fitues për pozitën *Zyrtar Sprovues*.

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se organi I punësimit me rastin e refuzimit të aplikacionit, nuk ka vërtetur drejtë gjendjen faktike, rrjedhimisht I ka kërkuar Këshillit, të anulohet procedura e rekrutimit deri tek akti në fjalë.

Kolegji i Këshillit, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “*Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen e Konkursit publik me numër reference RN000018927 për pozitën *Zyrtar Sprovues*, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomën e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor: Juridik, Ekonomik(pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi. Histori, Shkenca politike, Psikologji, Punë sociale, Gjeografi, Administrat Publike, Përvoja e punës e kërkuar:* *Së paku një (1) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës; Kërkesat Specifike:* *Nuk ka.*

Rrjedhimisht, Kolegji me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuses, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publikë, përkatësisht nenit 9 paragrafi 1, ku përcaktohet se: 1. *Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj*”, si dhe nenit 6 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: 2. *Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim: 2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit; 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.*

Bazuar në kuadrin përkatës ligjor, si dhe nga shqyrtimi dhe analizimi i provave të lëndës, Kolegji ka gjetur se pretendimi ankimor i ankuses për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike është i bazuar, ngase ashtu sikurse u tha me lartë në arsyetim të këtij vendimi, sipas konkursit të shpallur me numër reference

RN18927 për pozitën *Zyrtar Sprovues, i ka plotësuar Kërkesat e përgjithshme Formale, ndërsa Divizioni i Burimeve Njerëzore i Shërbimit Sprovues të Kosovës me Vendimin e datës 10.12.2025 ka refuzuar aplikacionin e ankueses me arsyetimin se nuk ka bashkangjitur trajnimet profesionale, sipas kërkesës së konkursit. Nga analizimi i dosjes se ankueses rezulton se e njëjta me rastin e aplikimit të datës 16.09.2025 ka bashkangjitur Diplomën me Nr.10681 të lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, me të cilën dëshmohet se e njëjta ka përfunduar studimet me 25.05.2012, dhe me këtë përvojë pune: sipas Kontratës së punës për periudhë të caktuar kohore prej datës 20.06.2012-19.12.2012 në pozitën Recepcioniste në Swis Diamond Hotel dhe sipas Kontratës së punës për periudhë të caktuar kohore prej datës 20.12.2012-19.06.2013 në pozitën Recepcioniste në Swis Diamond Hotel. Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesja plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara si më sipër, për të vazhduar tutje në fazat e vlerësimit profesional të kandidatëve.*

Kështu që, nisur nga rrethanat dhe konstatimet e dhëna si në arsyetim të këtij vendimi, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, Njësia e Burimeve Njerëzore në Shërbimin Sprovues të Kosovës, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, në fazën e verifikimit paraprak, gjegjësisht me rastin e përgatitjes së listës së ngushtë të kandidatëve që nuk plotësojnë kriteret e konkursit, rrjedhimisht me rastin e refuzimit të aplikacionit të ankueses nuk ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike si dhe gabimisht ka zbatuar ligjin material, ngase për pozitën e punës *Zyrtar Sprovues*, nuk ka përfshirë në listë të ngushtë kandidatët të cilët i kanë plotësuar kriteret e konkursit, veprime këto në kundërshtim me dispozitat e Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenin 39 paragrafi 5 dhe 6, ku përcaktohet se: *7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; ndërlidhur me nenin 9 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të këtij Ligji.*

Andaj, bazuar si më sipër, Kolegji i Këshillit me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë, vendosi që të shfuqizoj të gjitha veprimet administrative për konkursin me numër reference RN00018927 të datës 27.10.2025, për pozitën *Zyrtar Sprovues*, me detyrimin që në këtë rast Shërbimi Sprovues i Kosovës të merr parasysht të gjeturat dhe pikëpamjet juridike sipas këtij vendimi, përkatësisht procedura sipas konkursit përkatës, duhet të vazhdoj më fazën e verifikimit të aplikacioneve për të gjithë kandidatët duke përfshirë këtu edhe ankuesen, dhe e njëjta të zhvillohet në pajtueshmëri të plotë me dispozitat ligjore.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA, A.nr.2085/2025**

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses S.G-S;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Sprovues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së